



ANRD

ALBANIAN NETWORK FOR RURAL DEVELOPMENT
RRJETI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN RURAL

RAPORTI VJETOR 2024

RRJETI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN RURAL

Raporti Vjetor 2024

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural

VIZIONI YNË

Vizioni ynë afatgjatë “Europa në Shqipërinë Ruale” fokuson përpjekjet tona për t’u shndërruar në një aktor të rëndësishëm që shtyn përpara procese dhe reforma që avancojnë interesat dhe prioritetet e komuniteteve rurale dhe përshpejtojnë këto procese drejt modeleve dhe praktikave pozitive evropiane për një Shqipëri me komunitete rurale të gjallëruara, përfshirëse, pjesëmarrëse, aktive dhe kontribuese për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së jetës.

MISIONI YNË

Formësimi i një zëri të qartë, efektiv e të qëndrueshëm në mbështetje të komuniteteve rurale sipas filozofisë së zhvillimit rural tëudhëhequr nga komuniteti.

PARIMET e promovuara nga ANRD janë të bazuara në praktikat e mira evropiane:

- o Zhvillimi i qëndrueshëm rural social dhe ekonomik, me bazë territorin dhe veçantitë specifike të tij, duke aktivizuar komunitetet e mbetura pas në proceset e zhvillimit përmes qasjes nga poshtë-lart që fuqizon aktorët dhe rrit pjesëmarrjen e tyre;
- o Qasja e integruar ndërsektoriale dhe shumë aktorësh në dobi të zhvillimit rural, përmes rrjetëzimit, shkëmbimit të përvojave dhe ndërtimit të partneriteteve lokale duke shfrytëzuar idetë inovative;
- o Financimi dhe menaxhimi i projekteve lokale nga burime të ndryshme financiare si kontribut dhe konfirmim i kredibilitetit dhe rëndësisë së projekteve lokale.

“Jeta buron nga fshati”- është një e vërtetë e madhe se zhvillimi dhe përparimi i Shqipërisë vjen nga zonat e saj rurale. Për të arritur këtë vizion, nevojiten politika aktive, të qëndrueshme dhe nxitëse në zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor dhe rural, të cilat fokusohet në nevojat, prioritetet dhe aspiratat e komuniteteve vendore.

Deklarata e Parlamentit të Tretë Rural Kombëtar

“Është domosdoshmëri integrimi i grave nga zonat rurale në tregun e punës dhe zhvillimi i aftësive të tyre sipërmarrëse. Në këtë drejtim, strukturat vendore dhe qeverisja lokale duhet të luajnë një rol shumë të rëndësishëm për fuqizimin ekonomik të grave.”

Zheni Gjergji, Kryetare e Komisionit Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, (Edicioni i VI Pro Grave Rurale)

“Eventi Pro Grave Rurale na mblodhi së bashku jo vetëm për këtë event, por edhe për të konkretizuar çfarë duhet të ndryshojmë me instrumentet tona për të sjellë më shumë mbështetje financiare të drejtpërdrejtë në fokusin tuaj. Skemat Kombëtare për Bujqësinë duhet të kenë një zë më të fuqishëm për gratë sipërmarrëse, në mënyrë që produktet e tyre të njihen jo vetëm në tregjet kombëtare, por edhe në ato ndërkombëtare.”

Anila Denaj, Ministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (Edicioni i VI Pro Grave Rurale)

“Sot, fokusi ynë është mirëqenia e grave dhe vajzave të komuniteteve rurale. Njohja e sfidave dhe gjetja e zgjidhjeve praktike për to është hapi i parë për të avancuar dialogun me strukturat politikëbërëse, duke lehtësuar kështu përballimin e këtyre sfidave”.

Majlinda Hoxha, Sekretare e Përgjithshme e ANRD, (Edicioni i VI Pro Grave Rurale)

“Rijetëzimi i GVV “Kolonja e Gjelbër” erdhi përmes një procesi të gjatë dhe dinamik në thelb të të cilit qëndron bashkëpunimi midis shumë aktorëve. Ky proces u udhëhoq nga Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural, mbështetja e të cilit ka shkuar përtej mbështetjes profesionale dhe na ka shtuar besimin në qasjen LEADER.”

Paskal Vogli, Drejtor Ekzekutiv, Grupi Vendor i Veprimit “Kolonja e Gjelbër”, Festa “Miqë e Malit”, 7 shtator 2024

Mesazh nga Koordinatorja Kombëtare

Të nderuar anëtarë të Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural, partnerë, bashkëpunëtorë dhe miq të punës sonë,

Prej afro një dekade, ANRD ka bërë përpjekje të vazhdueshme për t'u kthyer në zërin e komuniteteve rurale, për të nxitur zhvillimin e gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm të zonave rurale të Shqipërisë. Viti 2024 dëshmoi sërish energjinë, përkushtimin dhe profesionalizmin me të cilin anëtarësia, bordi dhe stafi i ANRD punojnë për të përmbushur këtë mision.

Raporti vjetor që këni në dorë është më shumë se një dokument që përmbledh aktivitete e rezultate: është pasqyrë e përpjekjeve tona të përbashkëta, e partneriteteve të qëndrueshme dhe e besimit që shumë aktorë kombëtar e ndërkombëtarë kanë vendosur tek ne. Falë mbështetjes së donatorëve, veçanërisht Bashkimit Evropian, UN Women, AICS dhe GIZ, etj., ne kemi mundur të avancojmë programe, nisma dhe aktivitete të cilat në qendër të tyre kanë nevojat dhe prioritetet e komuniteteve rurale dhe grupeve të ndryshme si fermerë e prodhues të vegjël, gratë dhe të rinjtë në zonat rurale, komunitetet rurale të largëta etj, si dhe i kanë dhënë peshë reale rolit të shoqërisë civile në zhvillimin rural.

Viti 2025 na gjen të angazhuar në:

- forcimin e qasjes LEADER dhe konsolidimin e 6 Grupeve Vendore të Veprimit;
- organizimin e edicionit të 7-të të Pro Grave Rurale, si një platformë gjithëpërfshirëse për fuqizimin e grave rurale;
- përgatitjen e Parlamentit të 4-të Rural Shqiptar, si një platformë unike e dialogut civil për politikat rurale;
- konsolidimin e Qendrës së Rinisë Rurale, një hub që bën bashkë 300 të rinj nga komunitetet rurale;

- lançimin e Fondit të Akademisë “Nga Ferma në Tryezë”, mbështetja e parë financiare për GVV-të në Shqipëri;
- forcimin e rolit tonë në konsultime kombëtare për strategjitë dhe politikat që prekin drejtpërdrejt komunitetet rurale;
- diversifikimin dhe rritjen e burimeve financiare për të mbështetur një rol më aktiv të ANRD.


Në këtë vit që shënon 10-vjetorin e ANRD (2025), ndalemi për të reflektuar mbi rrugëtimin tonë: një dekadë përpjekjesh, arritjesh dhe mësimesh. Kjo përvojë na fton të shohim drejt së ardhmes me përgjegjësi edhe më të madhe. Sfidat me të cilat përballet zhvillimi i qëndrueshëm të tilla si pabarazitë gjinore, ndryshimet demografike, largimi i të rinjve nga komunitetet rurale, ndryshimet klimatike, humbja e biodiversitetit etj., kërkojnë sot më shumë se kurrë të forcojmë rrjetëzimin tonë dhe të intensifikojmë përpjekjet tona të përbashkëta për të garantuar mirëqeverisjen e sektorit bujqësor dhe rural.

ANRD synon të forcojë më tej rolin e vet si partner strategjik dhe instrument i besueshëm për politikëbërjen dhe mirëqeverisjen e sektorit rural. Ne besojmë fort se advokacia nga poshtë-lart është çelësi për demokraci funksionale, për përfshirje sociale dhe për progres drejt integritit evropian dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

Në emër të anëtarësisë së ANRD, bordit dhe stafit, shpreh mirënjohje për të gjithë partnerët, donatorët dhe miqtë tanë që kanë qenë pjesë e këtij rrugëtimi.

Evelina Azizaj
Koordinatorë Kombëtare

SHIFRA DHE FAKTE 2024



AKTIVITETE 2024

Ceremonia hapëse e Akademisë “Nga Ferma në Tryezë” [shkurt 2024]

Në kuadër të projektit [Akademia nga Ferma në Tryezë për Ballkanin Perëndimor të Gjellbër-E ardhmja jonë e përbashkët Evropiane](#), ANRD organizoi [ceremoninë hapëse](#) të Akademisë “Nga Ferma në Tryezë” më 13 shkurt, në Tiranë. Aktiviteti mbledhi përfaqësues nga Rrjetet Kombëtare të Zhvillimit Rural të Ballkanit Perëndimor, organizata të shoqërisë civile, Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, EU TACSO Shqipëri, si dhe akademikë. Gjatë ceremonisë u prezantua një vlerësim i kapaciteteve të OSHC-ve mbi sistemet e qëndrueshme ushqimore dhe rolin e tyre në tranzicionin e gjellbër, si dhe u paraqit Korniza Strategjike e Akademisë. Projekti Akademia “Nga Ferma në Tryezë” kontribuon në zbatimin e shtyllës së pestë të Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor – *Sistemet e qëndrueshme të ushqimit* – duke synuar forcimin e rolit të OSHC-ve në të gjashtë vendet e rajonit për përafrimin me Marrëveshjen e Gjellbër të BE-së dhe Strategjinë “Nga Ferma në Tryezë” e BE.

Takimi konsultues mbi Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Agroturizmit në Shqipëri [shkurt 2024]

ANRD organizoi në shkurt [takimin konsultues mbi dokumentin strategjik “Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Agroturizmit në Shqipëri](#). Ky takim mbledhi së bashku përfaqësues nga organizatat anëtare të ANRD,

Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Universiteti Bujqësor i Tiranës, institucione të tjera qendrore si edhe aktorë të tjerë relevantë. Pjesëmarrësit ndanë këndvështrimet dhe sugjerimet e tyre mbi dokumentin e publikuar dhe sollën propozime konkrete në funksion të përmirësimit të tij. Ky takim konsulties ofroi një hapësirë konstruktive diskutimi për mbledhjen e sugjerimeve dhe kontributeve të nevojshme për forcimin e Strategjisë. Ai shënoi një moment të rëndësishëm në kuadër të përpjekjeve të vazhdueshme të ANRD për të unifikuar interesat dhe prioritetet e komuniteteve rurale, për t'i lidhur ato me qeverisjen si dhe për të ndikuar në politikat dhe veprimet e institucioneve dhe aktorëve të ndryshëm të interesit.

Takimi me Komisionerin për mbrojtjen nga diskriminimi [shkurt 2024]

Në vijim të ndarjes së [Deklaratës së Grave dhe Vajzave në Zonat Rurale](#), ANRD [zhvilloi një takim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi](#), z. Robert Gajda. Në këtë takim u ndanë këndvështrime mbi stereotipet dhe pabarazitë gjinore me të cilat gratë dhe vajzat në komunitetet rurale ishin përballur në mënyrë të vazhdueshme. Ndërgjegjësimi dhe zbutja e këtyre pabarazive dhe stereotipeve u theksuan si prioritet të përbashkëta të ANRD dhe institucionit të Komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi. Takimi identifikoi një sërë çështjesh dhe prioritetesh që kërkonin angazhimin e dyanshëm dhe bashkëpunim të vazhdueshëm institucional dhe shoqëror. Eliminimi i stereotipeve dhe pabarazive gjinore është i domosdoshëm për fuqizimin social dhe ekonomik të grave dhe vajzave në zonat rurale, për rritjen e dukshmërisë së kontributit të tyre në zhvillimin bujqësor dhe rural, si edhe për përfshirjen e tyre aktive në ekonomi dhe në jetën komunitare.

Programit të bursave për fermerët e rinj në qarkun e Shkodrës, Kukësit dhe Dibrës

Programi i bursave për fermerët e rinj të talentuar në qarkun e Shkodrës, Kukësit dhe Dibrës ka si qëllim fuqizimin e sipërmarrësve të rinj të angazhuar në sektorin e bujqësisë, në zinxhirët e agro-ushqimor në qarqet e Shkodrës, Kukësit dhe Dibrës. Përgjatë vitit 2024, janë identifikuar dhe mbështetur 10 të rinj nga zonat rurale të këtyre qarqeve, duke i ndihmuar ata të zhvillojnë dhe përmirësojnë aftësitë e tyre, si dhe të sigurojnë burime për të rritur dhe zhvilluar bizneset e tyre në fushën e bujqësisë.

Përmes kurseve të trajnimit të kualifikuar programi do të nxisë rritjen e njohurive të tyre dhe do të sigurojë mbështetje financiare për blerjen e inputeve të prodhimit, inovacioneve teknologjike dhe diversifikimin e fermave. Përmbushja e këtij qëllimi synon të krijojë një efekt zinxhir që do të mbështesë avancimin e fermerëve të rinj drejt suksesit në sipërmarrje duke kontribuar kështu në zhvillimin rural dhe përmirësimin e cilësinë së jetesës në komunitetet e tyre.

Sesionet informuese në kuadër të "Programit të bursave për fermerët e rinj në qarkun e Shkodrës, Kukësit dhe Dibrës" [prill 2024]

Në kuadër të "Programit të bursave për fermerët e rinj në qarkun e Shkodrës, Kukësit dhe Dibrës", gjatë muajit prill u zhvilluan tre sesione informuese me të rinj dhe aktorë të tjerë relevantë për të prezantuar programin tek pjesëmarrës potencialë. Gjatë këtyre takimeve u prezantua programi, kriteret e pranimit dhe mënyra e aplikimit, me qëllim që procesi i përfshirjes së të rinjve të interesuar të ishte sa më i qartë dhe i lehtësuar. Sesionet shërbyen gjithashtu si platformë komunikimi për të nxitur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e mbështetjes së të rinjve në sektorin e bujqësisë dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen e tyre aktive në zhvillimin rural.

Workshopi i Programit të Bursave për projektin Ruralbania [korrik 2024]

Në kuadër të projektit Ruralbania u në korrik u zhvillua dita e parë e [workshopit të programit të bursave për fermerët e rinj](#) ku pjesëmarrësit u njohën me aktivitetet e ndryshme që mund të ndërmerrnin për diversifikimin e fermave dhe me mundësitë e trajnimeve ku mund të angazhoheshin gjatë kësaj periudhe. Ata gjithashtu u prezantuan Qendrën e Rinisë Rurale dhe me përfitimet që pjesëmarrja aktive në këtë rrjet të rinjsh nga e gjithë Shqipëria mund t'u sillte. Gjatë ditës së dytë, secili pjesëmarrës krijoi një plan të strukturuar për të arritur qëllimet e tij, duke u fokusuar në zhvillimin personal dhe profesional.

Trajnimi mbi qasjen LEADER [prill 2024]

ANRD organizoi në prill trajnimin njëditor “[Zbatimi i qasjes LEADER: Nga animimi i territorit te zbatimi i strategjive lokale të zhvillimit](#)” ku morën pjesë përfaqësues të organizatave anëtare të ANRD, përfaqësues të GIZ, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Grupeve Vendore të Veprimit, si edhe aktorë të tjerë të interesuar. Trajnimi kishte si synim përmirësimin e njohurive dhe aftësive praktike të aktorëve vendorë që kanë potencial të promovojnë dhe mbështesin zbatimin e qasjes LEADER. Diskutimet dhe puna në grupe u fokusuan në rëndësinë e animimit të territorit, proceset me pjesëmarrje për krijimin e GVV-ve, formulimin me pjesëmarrje të strategjive të zhvillimit vendor, si dhe ofrimin e mbështetjes për GVV-të në zbatimin e nismave lokale.

Përpyjekjet e advokacisë rinore përmes takimeve me insitucionet publike [shkurt-maj 2024]

Në vijim të ndarjes së Deklaratës së Asamblesë së Parë të të Rinjve nga Zonat Rurale, përfaqësues të RYH kanë zhvilluar një seri takimesh me institucionet publike për të ndarë sfidat dhe prioritetet e të rinjve ruralë dhe rekomandime konkrete për të përmirësuar situatën e tyre socio-ekonomike. Përgjatë muajve shkurt-maj 2024, u zhvilluan takime me [përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Rinisë](#), [Ministren e Rinisë dhe Fëmijëve](#) dhe [Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural](#). Këto takime shërbyen për të çuar më tej përpjekjet për t'i bërë politikat zhvillimore të lidhura ngushtë me nevojat e të rinjve nga komunitetet rurale.

Takimi me përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural [qershor 2024]

Një përfaqësi e ANRD zhvilloi një [takim me z. Enio Civici, zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural](#) mbi çështje kyçe të zhvillimit rural dhe bujqësor, përfshirë nismat që ANRD dhe organizatat anëtare kishin në proces zbatimi, me synim krijimin e sinergjive me programet dhe planet e Ministrisë. Fokusi kryesor i diskutimit ishte prezantimi dhe dorëzimi i [Deklaratës së Parlamentit të Tretë Rural Shqiptar](#), dokument që reflektonte prioritetet dhe nevojat e komuniteteve rurale. Në përfundim të takimit, u dakortësua për të vijuar me nënshkrimin e një Marrëveshjeje Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Parlamentit Kombëtar Rural.

Takimi vjetor i Asamblesë së Përgjithshme të ANRD [qershor 2024]

[Asambleja e Përgjithshme e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural u mblodh më](#) 14 qershor 2024 duke sjellë përfaqësuesit e organizatave anëtare për të rishikuar arritjet e vitit të kaluar dhe diskutuar veprimet për të

ardhmen. Disa nga momentet kyçe të agjendës së takimit përfshijnë prezantimin dhe aprovimin [e raportit vjetor](#) të vitit të kaluar, shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave të reja për anëtarësi, diskutimin mbi platformat e advokacisë së ANRD, prezantimi dhe diskutimi mbi hartimin e strategjisë së re të organizatës dhe çështje të tjera relevante.

Një moment i rëndësishëm i asamblesë ishte përzgjedhja e anëtareve të rinj të bordit. Në përfundim, ANRD u zgjerua tematikisht dhe gjeografikisht me organizata të reja dhe u formua një bord i ri, i cili u zgjodh duke respektuar parimet e përfaqësimit territorial, barazisë gjinore dhe përfshirjes së të rinjve në strukturën e tij.

Workshopi për hartimin e strategjisë së ANRD [qershor 2024]

Në qershor, u zhvillua [workshop-i për mbledhjen e kontributeve dhe mendimeve për hartimin e strategjisë së ANRD](#), me pjesëmarrjen e një grupi përfaqësues të anëtarësisë dhe stafit të ANRD. Gjatë aktivitetit u përdor metodologjia inovative *Compass*, duke krijuar një ditë pune interaktive të mbushur me diskutime dhe punë në grupe.

Fokusi kryesor i punës në grupe ishte identifikimi i faktorëve kyç të suksesit të ANRD. Pjesëmarrësit demonstuan energji pozitive dhe angazhim të lartë gjatë të gjithë aktivitetit. Rezultatet dhe momentet më të rëndësishme të diskutimeve u prezantuan në Asamblenë e Përgjithshme Vjetore të ANRD, për të nxitur më tej procesin e konsultimit me anëtarët dhe për të mbështetur zhvillimin e strategjisë së organizatës për periudhën e ardhshme.

Aktiviteti përmbyllës i kampit veror “Kruja Artizanale: E ardhmja ishte në origjinë” [qershor 2024]

Kampi veror “Kruja Artizanale: E ardhmja është në origjinë” [u përmbyll përmes një dite të mbushur me momente të bukura dhe të paharrueshme](#) për pjesëmarrësit. Fëmijët, gjyshërit e tyre, familjarë të tjerë dhe artizanët vizituan kalanë e qytetit, një destinacion të njohur për turistë dhe vizitorë. Gjatë aktiviteteve, fëmijët prezantuan punimet e tyre dhe treguan atë që kishin mësuar gjatë kampit. Ata theksuan rëndësinë e traditës së pasur të qytetit dhe lidhjen e të ardhmes me traditat e të parëve, duke nënvizuar nevojën për t’i mbrojtur, promovuar dhe pasuruar. Në ditën e fundit, fëmijët vlerësuan cilësitë më të mira të shokëve dhe shoqeve të tyre, duke përdorur fjalë si: e mirë, punëtore, e buzëqeshur, e sjellshme, e mençur, e bukur, interesante, e ëmbël, artizane dhe të tjera. Në përfundim të kampit, fëmijët kishin fituar njohuri për teknikat e punës me dorë dhe kishin zhvilluar aftësi për të krijuar punime artizanale.

Trajnimet Rajonale të Trajnerëve të Akademisë nga Ferma në Tryezë [shkurt-shtator 2024]

Në periudhën shkurt- shtator 2024, ANRD ka organizuar katër Trajnimit Rajonal të Trajnerëve (ToT) mbi bujqësinë e qëndrueshme dhe zhvillimin rural në kuadër të projektit [Akademia nga Ferma në Tryezë për Ballkanin Perëndimor të Gjellbër-E ardhmja jonë e përbashkët Evropiane](#). Programi i ToT mbuloi katër module: bujqësia organike, hortikultura e qëndrueshme, agroekologjia dhe ekonomia qarkulluese. Këto trajnime u zhvilluan në zona të ndryshme të vendit si Tirana, Durrësi, Shkodra dhe Vlora dhe mblodhi së bashku pjesëmarrës nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Serbia. Secili

prej Rrjeteve Kombëtar për Zhvillim Rural në vendet e Ballkanit Perëndimor nominoi për çdo trajnim rajonal nga dy përfaqësues nga OSHC që janë aktive në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Programi i trajnimeve rajonale pajisi 55 pjesëmarrës (58% gra dhe 38% të rinj) nga vendet e Ballkanit Perëndimor me njohuri dhe aftësi praktike për të transferuar praktikat e bujqësisë së qëndrueshme dhe zhvillimit rural tek organizatat lokale në vendet përkatëse.

Tabela më poshtë paraqet informacion mbi trajnimet rajonale, duke përfshirë numrin e pjesëmarrësve, sipas gjinisë dhe moshës.

Trajnimet rajonale	Datat dhe vendi	Numri i pjesëmarrësve	Femra	18-40 vjeç
<u>Trajnimi i Parë</u>	Shkurt 2024, Tiranë	16	11	5
<u>Trajnimi i Dytë</u>	Prill 2024, Durrës	15	7	6
<u>Trajnimi i Tretë</u>	Qershor 2024, Shkodër	13	7	5
<u>Trajnimi i Katërt</u>	Shtator 2024, Vlorë	11	7	5
Total		55	32	21

Trajnimet Kombëtare mbi Bujqësinë e Qëndrueshme dhe Zhvillimin Rural [mars-tetor 2024]

Në vijim të trajnimeve rajonale, ANRD zhvilloi katër trajnime kombëtare për OSHC të angazhuara në

sektorin e bujqësosë dhe zhvillimit rural në Shqipëri në kuadër të projektit [Akademia nga Ferma në Tryezë për Ballkanin Perëndimor të Gjelbër-E ardhmja jonë e përbashkët Evropiane](#). Trajnimet kombëtare u zhvilluan në periudhën mars- tetor 2024 në Durrës, Pogradec, Shkodër dhe Vlorë. Për secilin trajnim, njëri nga pjesëmarrësit e trajnuar në trajnimet rajonale u angazhua me dhënien e trajnimit në nivel kombëtar për të njëjtat module bujqësia organike, hortikultura e qëndrueshme, agroekologjia dhe ekonomia qarkulluese. Pjesëmarrësit në trajnimet kombëtare u përzgjedhën përmes një thirrjeje të hapur, ku u përzgjedhën përfaqësues të OSHC-ve, të rinj të angazhuar në sektorin e bujqësisë dhe aktorë të tjerë relevantë që punojnë ngushtësisht me fermerët. Megjithëse numri i synuar ishte 15 pjesëmarrës për trajnim, interesi i lartë nga OSHC-të bëri që pjesëmarrja të rritej. Në total, në trajnimet kombëtare në Shqipëri morën pjesë 67 pjesëmarrës, prej të cilëve 48% ishin gra dhe 40% të rinj (18-40 vjeç).

Trajnim kombëtar	Data dhe vendi	Numri i pjesëmarrësve	Femra	18-40 vjeç
Trajnimi i Parë	Mars 2024, Durrës	17	7	8
Trajnimi i Dytë	Prill 2024, Pogradec	21	11	5
Trajnimi i Tretë	Qershor 2024, Shkodër	15	10	9
Trajnimi i Katërt	Tetor 2024, Vlorë	14	4	5
Total		67	32	27

Edicioni i VI-të ‘Pro Grave Rurale: Gratë e komuniteteve rurale ruajtëse të natyrës për të ardhmen e përbashkët [tetor 2024]

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Grave Rurale, Rrjeti Shqiptar për Zhvillim Rural dhe organizatat e veta anëtare të angazhuara në fuqizimin e grave dhe barazinë gjinore në bujqësi dhe zhvillimin rural, organizoi me sukses Edicionin e gjashtë të eventit “[Pro-Grave Rurale](#)”, më 15 tetor 2024 në ambientet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Dita Ndërkombëtare e Grave Rurale shërben si një platformë e qëndrueshme për t’u përfshirë në diskutime rreth sfidave dhe prioriteteve të tyre. Ky edicion bëri bashkë më shumë se 80 pjesëmarrës, ndër të cilët gra dhe vajza të komuniteteve rurale nga Dibra, Erseka, Elbasani, Puka, Shkodra, Durrësi etj. përfaqësues të institucioneve publike dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe aktorë të tjerë të përfshirë në fuqizimin e grave nga zonat rurale, të cilët diskutuan rreth sfidave që pengojnë produktivitetin e tyre në sektorin agro-ushqimor.

Një momentet tepër i veçantë i eventit ishte dhënia e çmimit “Liljana Isakaj” Për Lidërsip në Fuqizimin e Grave të Zonave Rurale, një nismë kushtuar nderimit të trashëgimisë së jashtëzakonshme të Zj. Liljana Isakaj, e cila ia kushtoi jetën e saj zhvillimit rural dhe fuqizimit ekonomik të grave rurale. Komiteti vlerësoi me këtë çmim Zj. Marie Frroku nga Gjegjan, Pukë e cila është lidere e Grupit të Grave të Gjegjanit dhe për më shumë

se 20 vitesh i është dedikuar fuqizimit të grave në zonën e Pukës.

Edicionit të gjashtë të Pro-Grave Rurale ishte një mundësi për përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe institucione të qeverisjes vendore dhe qendrore, organizata për të drejtat e njeriut dhe aktorë të tjerë, të njihen me rolin e grave në bujqësi dhe zhvillimin rural, dhe ruajtjen e natyrës për të ardhmen e përbashkët.

Aktivitet ndërgjegjësues mbi Ditën Botërore të Ushqimit [tutor 2024]

Në kuadër të Ditës Botërore të Ushqimit, ANRD zhvilloi [një aktivitet ndërgjegjësues në ambientet e Universitetit Bujqësor të Tiranës](#). Ky aktivitet kishte për qëllim promovimin e kësaj dite si një hap i rëndësishëm drejt ndërtimit të sistemeve të qëndrueshme ushqimore, në përputhje me zbatimin e Strategjisë “Nga Ferma në Tryezë”. Tema e këtij viti, “E drejta për t’u ushqyer për një jetë dhe të ardhme më të mirë”, solli në vëmendje të drejtën themelore të çdo njeriu për të patur akses në ushqim të shëndetshëm në çdo kohë. Diskutimet u fokusuan në disa çështje kyçe, si e drejta për ushqim, siguria ushqimore, sistemet e qëndrueshme agro-ushqimore, si dhe sfidat që lidhen me urinë dhe kequshqyerjen.

Procesi i konsultimit me pjesëmarrje për forcimin e pozicionit të fermerëve në zinxhirët e vlerës [tutor – nëntor 2024]

Në kuadër të projektit [Akademia nga Ferma në Tryezë për Ballkanin Perëndimor të Gjellbër-E ardhmja jonë e përbashkët Evropiane](#), përgjatë periudhës tutor- nëntor 2024 u zbatua një proces me pjesëmarrje për forcimin e

pozicionit të fermerëve në zinxhirët e vlerës së bimëve mjekësore dhe aromatike dhe qumështit.

Ky proces konsultimi pati si qëllim kryesor mbledhjen e kontributeve nga fermerët e vegjël dhe shoqatat e tyre, si dhe nga aktorë të tjerë ruralë, për të identifikuar sfidat të cilat kufizojnë forcimin e pozicionit të fermerëve në zinxhirët e vlerës dhe ofrimin e rekomandimeve konkrete për fuqizimin e tyre. Në lidhje me këtë u organizuan pesë takime konsultuese me fermerët në zonat rurale të Malësisë së Madhe, Belshit, Beratit, Lushnjes dhe Zall-Herit.

Në total, në këtë proces u angazhuan rreth 78 pjesëmarrës, nga të cilët 21% ishin femra dhe 10% të rinj (18–40 vjeç).

Workshopi i parë udhëtues në kuadër të projektit Ruralbania [dhjetor 2024]

ANRD në bashkëpunim me ADAD Malore organizuan [Workshopin e parë udhëtues](#) në qarkun e Dibrës, ku në kuadër të projektit Ruralbania është themeluar zyra e QABR-Dibër. Workshopi mbledhi sëbashku përfaqësues të institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile, shërbimit të ekstensionit etj., duke krijuar një platformë të hapur për diskutim dhe shkëmbim të ideve mbi sfidat dhe mundësitë e prodhuesve të vegjël bujqësorë të angazhuar në zinxhirin e vlerës së frutave të pyllit dhe bletarisë dhe perspektivës së tyre për të ardhmen.

Vizita e parë ishte pikërisht në ambientet e QABR, ku pjesëmarrësit u njohën me punën dhe arritjet, si dhe me

mënyrën e funksionimit të kësaj strukture. Më pas vizita vazhdoi me njohjen e rezultateve të prekshme të punës së projektit, duke u njohur me një nga fermerët e zonës i cili kishte marrë mbështetje të drejtpërdrejtë nga Ruralbania. Nëpërmjet këtyre workshopeve, ANRD synon të nxisë mundësi bashkëpunimi mes aktorëve të ndryshëm dhe eksplorimin e mundësive të rritjes së qëndrueshmërisë së këtyre zyrave edhe në të ardhmen.

Zbatimi i qasjes LEADER në bashkitë e Elbasanit, Kolonjës, Shkodrës, Pogradecit dhe Vlorës

Përgjatë vitit 2024 ANRD ka treguar përkushtim në zbatimin e qasjes LEADER si një nga instrumentet kryesore për zhvillimin e qëndrueshëm rural bazuar në parimin e pjesëmarrjes nga poshtë lart. Falë mbështetjes financiare të disa programeve të donatorëve të ndryshëm, ANRD është angazhuar në ofrimin e asistencës teknike në krijimin dhe mbështetjen e Grupeve Vendore të Veprimit (GVV).

Projekti “Fuqizimi i grave në zonat rurale dhe turizmi” mbështetur nga UN Women

ANRD në rolin e nënkontraktorit të UN Women dhe në bashkëpunim me bashkitë e Kolonjës dhe Elbasanit ka asistuar krijimin dhe themelimin e dy GVV-ve, konkretisht GVV “Kolonja e Gjelbër” dhe GVV “Egantia”. Procesi i krijimit të GVV-së, mobilizimit të komuniteteve lokale dhe hartimit të Planeve të Zhvillimit Lokal për dy zonat Leader ka qenë intensiv dhe dinamik. Kjo për të siguruar një proces gjithëpërfshirë, transparent dhe me pjesëmarrjen e gjithë aktorëve dhe komuniteteve të ndryshme të zonës. Përgjatë vitit 2024 janë organizuar [aktivitetet e fundit për rritjen e kapaciteve](#) të GVV-ve dhe takimet konsultuese ([Ersekë](#), [Elbasan](#)) për miratimin e Strategjive të Zhvillimit Vendor nga komunitetet lokale. Procesi ka ndihmuar në përmirësimin

e kapaciteteve të anëtarëve të GVV-ve, duke i aftësuar për të përmbushur rolin e tyre në strukturat e GVV- së dhe në komunitetin rurale, si dhe mbledhjen e kontributeve të nevojshme për hartimin e Strategjive të Zhvillimit Vendor.

Festa “Miqte e Malit”: Aty ku natyra dhe tradita bashkohen- GVV “Kolonja e Gjelbër”

GVV “Kolonja e Gjelbër” në bashkëpunim me Rrjetin Shqiptar për Zhvillimin Rural organizoi [Festën “Miqte e Malit”](#), më 7 shtator në Shën Pjetër, Ersekë. Festa bëri bashkë më shumë se 100 pjesëmarrës duke përfshirë banorë të komunitetit, dashamirës të natyrës si Korca Alpin, klubi i futbollit i fëmijëve i ekpit Gramozi, gra artizane nga Kolonja dhe Pogradeci dhe grupe turistësh e vizitorë. Gjithashtu të pranishëm ishin dhe përfaqësues të Bashkisë Kolonjë dhe institucioneve të tjera publike.

Ky event ofroi një eksperiencë të paharrueshme për pjesëmarrës të të gjitha moshave dhe interesave. Festa “Miqte e Malit” synoi promovimin e një prej atraksioneve kryesore të zonës, Malin e Gramozit, dhe rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e mbrojtjes së pasurisë natyrore dhe biodiversitetit të zonës.

Eksploro Egnatian- GVV “Egnatia”

Në kuadër të projektit [Eksploro Egnatian](#) zbatuar nga GVV “Egnatia” përgjatë vitit 2024 u zhvillua harta digjitale e “Via Egnatia”. Ky instrument interaktiv synon të dokumentojë dhe promovojë trashëgiminë natyrore, kulturore dhe historike përgjatë rrugës së lashtë *Via Egnatia*. Harta ofron orientim të qartë për vizitorët dhe studiuesit, duke shënuar shtigje, pika me interes dhe udhëzime praktike për eksplorim në terren. Përmes saj, përdoruesit

mund të aksesojnë informacione të verifikuara mbi destinacionet, duke e bërë më të lehtë ruajtjen dhe vlerësimin e kësaj pasurie historike dhe turistike.

Projekti rajonal i GIZ-it “SEDRA II” dhe zbatimi i qasjes Leader

Me mbështetjen e projektit rajonal “SEDRA II” të zbatuar nga GIZ, ANRD po ndihmon dy Grupe Vendore Veprimi në lidhje me përgatitjen e Strategjive të Zhvillimit Lokal, specifikisht GVV “Mokër-Gorë” në bashkinë e Pogradecit dhe GVV “Vjona” në bashkinë e Vlorës. Përgjatë vitit 2024 është finalizuar Strategjia e Zhvillimit Vendor dhe është zhvilluar [takimi konsultues](#) për miratimin e strategjisë nga komunitetet lokale. Nga ana tjetër në Vlorë, ANRD ka vijuar [me procesin e hartimit](#) dhe finalizimit të Strategjisë së Zhvillimit Vendor për GVV Vjonën. Procesi gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrës siguron që strategjitë e zhvillimit lokal të reflektojnë nevojat dhe prioritetet e komunitetit.

Pas përfundimit me procesit të hartimit të Strategjive të Zhvillimit Vendor, të dy GVV-të u mbështetën me fonde të vogla deri në 5,000 euro për të vijuar me zbatimin e strategjisë.

Zbatimi i programit të certifikimit të guidave lokale - GVV “Mokër-Gorë”

GVV “Mokër-Gorë” zbatoi [programin për certifikimin e guidave lokale](#) duke mbështetur trajnimin dhe certifikimin e një grupi prej pesë të rinjsh nga komunitetet lokale, të cilët ishin të apasionuar pas natyrës dhe kulturës së zonës. Pjesëmarrësit kanë përfituar njohuritë e nevojshme për udhëheqjen e vizitave dhe promovimin e bukurive dhe pasurive të veçanta të zonës.

Trajnimi mbi praktikat e mira bujqësore në kultivimin e ullirit - GVV “Vjona”

GVV “Vjona” organizoi një trajnim dyditor [mbi praktikat e mira bujqësore në kultivimin e ullirit për fermerët](#) në njësinë Administrative Qendër, Vlorë. Trajnimi shërbeu për rritjen e kapaciteteve të fermerëve mbi teknikat e kultivimit të ullirit, monitorimin e mizës së ullirit dhe sëmundjeve të tjera, ndikimin e metodave të vjeljes në cilësinë e vajit të ullirit, si dhe aspekte të tjera të rëndësishme të menaxhimit të fermës. Trajnimi përfshiu diskutime aktive dhe kontribut të fermerëve, duke reflektuar nevojën e tyre për njohuri praktike dhe mbështetje në vendimmarrjen bujqësore.

Projekti “Liqenet e Shqipërisë” dhe zbatimi i qasjes Leader për zhvillimin e turizmit të përgjegjshëm

Në rolin e organizatës partnere të konsorciumit të gjerë italo-shqiptar, me fonde të qeverisë italiane, ANRD po ofron ekspertizë teknike në krijimin e dy GVV-ve në zonat përreth dy liqeneve, Shkodrës dhe Pogradecit. Përgjatë vitit 2024 ka vazhduar puna me forcimin e kapaciteteve të GVV-së “Labeatët” në Shkodër dhe Malësi e Madhe, dhe GVV “Lyhnidas” në Pogradec. Gjithashtu, përgjatë këtij viti ka vazhduar puna me hartimin e dokumentit të politikave mbi turizmin e qëndrueshëm.

PJESËMARRJE NË AKTIVITETE KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE

Pjesëmarrje në edicionin e dytë të programit të lidërsipit për fermerët e rinj [mars 2024]

Anëtarët e RYH, Florand Zebi dhe Julvin Marku ishin pjesë [e edicionit të dytë të programit të lidërsipit të fermerëve të rinj](#) të BE-së, organizuar nga [CEJA Young Farmers](#). Ky event mbledhi bashkë 46 fermerë të rinj nga e gjithë Evropa në ambientet e EU CAP Network në Bruksel. Përgjatë këtij trajnimi 3-ditor, programi synoi t'u sigurojë liderve të ardhshëm në sektorin e bujqësisë aftësi themelore dhe të promovojë kapacitetin e tyre për të udhëhequr.

Study Session “Rural Youth Work 101” organizuar nga Rural Youth Europe [prill 2024]

Përfaqësues të RYH, Anxhela Meta, Alba Tema dhe Redi Asabella ishin pjesë e [Study Session “Rural Youth Work 101”](#) organizuar nga Rural Youth Europe. Në këtë aktivitet një javor u trajtua puna me të rinjtë në zonat rurale dhe vullnetarizmi si mjete për promovimin dhe avancimin e përfshirjes socio-politike të të rinjve në zonat rurale në Evropë. Pjesëmarrësit u pajisën me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të kontribuar në mënyrë aktive në ndërtimin e shoqërive më gjithëpërfshirëse dhe paqësore në të gjithë Evropën.

Pjesëmarrja në edicionin e parë të Young LEADER Forum [qershor 2024]

Hulumtuesja e re e ANRD, Alba Tema, mori pjesë në edicionin e parë [të Forumit Young LEADER](#), i organizuar nga EU CAP Network në bashkëpunim me Finnish Rural Network, më 11-13 qershor në Vierumäki, Finlandë. Forumi kishte për qëllim nxitjen e përfshirjes së të rinjve në zhvillimin e integruar të komuniteteve rurale

përmes implementimit të qasjes LEADER, duke vënë theksin mbi rolin e tyre si aktorë kyç në të ardhmen e zonave rurale. Aktiviteti ofroi një mundësi të rëndësishme për shkëmbimin e njohurive dhe përvojave mes të rinjve nga vende të ndryshme të Evropës.

Vizita studimore në kuadër të projektit “TOKA JONË: Ripërdorimi i tokave të konfiskuara për promovimin e bujqësisë sociale” [shtator 2024]

Në kuadër të projektit “TOKA JONË: Ripërdorimi i tokave të konfiskuara për promovimin e bujqësisë sociale”, ANRD mori pjesë [në vizitën studimore të zhvilluar në Cremona, Itali](#). Aktiviteti përfshin vizita në sipërmarrje sociale bujqësore si dhe punëtori me ekspertë të fushës, me synimin për të përcjellë praktikat më të mira drejt tre sipërmarrjeve sociale bujqësore që mbështeten nga projekti në Yzberisht dhe Shijak. Kjo nismë thekson rëndësinë e sipërmarrjeve sociale si një nga modelet më të suksesshme për zhvillimin socio-ekonomik të grupeve vulnerabël. Përtej dimensionit ekonomik, këto sipërmarrje synojnë fuqizimin e komuniteteve dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm social.

Pjesëmarrje në trajnim: “Punonjësit rinor në aksion për natyrën dhe mirëqenien mendore” [shtator 2024]

Të rinjtë e Qendrës së Rinisë Rurale, me mbështetjen e ANRD morën pjesë në trajnimin “[Punonjësit rinor në aksion për natyrën dhe mirëqenien mendore](#)”, i cili u zhvillua në Sllovaki. Ky trajnim kishte për qëllim t’i pajiste pjesëmarrësit me njohuri dhe mjete të nevojshme për të krijuar përvoja pozitive për të rinjtë dhe për të

ndërtuar një lidhje më të fortë me natyrën. ANRD mbetet e përkushtuar në mbështetjen e të rinjve nga zonat rurale, duke theksuar se fuqizimi i brezit të ri është një parakusht për zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve.

Forumi i Nivelit të Lartë për Zgjerimin “Drejt një Zgjerimi të Suksesshëm të BE-së” [tetor 2024]

Koordinatorja Kombëtare e ANRD, Evelina Azizaj, mori pjesë në [Forumin e Nivelit të Lartë për Zgjerimin “Drejt një Zgjerimi të Suksesshëm të BE-së”](#), i organizuar më 24 tetor nga Komiteti Ekonomik dhe Social Evropian, në cilësinë e saj si Anëtare Kandidate për Zgjerimin. Ky forum mbledhi së bashku përfaqësues të nivelit të lartë nga Komisioni Evropian, shtetet anëtare, si dhe vendet kandidate dhe ato potencialisht kandidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Diskutimet e forumit nënvizuan rolin e rëndësishëm të dialogut social dhe shoqërisë civile në progresin drejt anëtarësimit, duke theksuar domosdoshmërinë e ruajtjes së vlerave themelore të BE-së. Gjithashtu, forumi shërbeu si një moment i rëndësishëm për të rishikuar arritjet e deritanishme të EESC-së dhe për të vlerësuar drejtimin e ardhshëm të nismës pilot të ECMs në të ardhmen.

Takimi i tretë rajonal mbi Mbështetjen Financiare për Palët e Treta [nëntor 2024]

ANRD mori pjesë në takimin e tretë rajonal [“Mbështetje Financiare për Palët e Treta” \(FSTP\)](#), i organizuar nga EU TACSO (Asistenca teknike e BE për OSHC-të). Takimi u zhvillua në Shkup, Maqedoni e Veriut, dhe mbledhi së bashku rreth 50 përfaqësues të organizatave që zbatojnë skemat e FSTP-së në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, përfshirë edhe disa përfitues të mbështetjes me nën-grante.

Diskutimet u përqendruan në praktikat aktuale të zbatimit të FSTP, ndryshimet organizative të evidentuara në nivelin e zbatuesve, si dhe efektet pozitive të mbështetjes me grante të vogla për organizatat e shoqërisë civile në rajon. Pjesëmarrja në këtë takim ofroi një mundësi të rëndësishme për shkëmbimin e përvojave dhe forcimin e rolit të ANRD-së si aktor i angazhuar në fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile përmes mekanizmave të mbështetjes financiare.

Forumi Social për të Drejtat e Fermerëve dhe Agroekologjinë në Europën Qendrore dhe Lindore [dhjetor 2024]

Evelina Azizaj, Koordinautore Kombëtare e ANRD, dhe Rozeta Mihali, përfaqësuese e COSPE Onlus, morën pjesë në Forumin Social “[Fermerët e vegjël advokojnë për të drejtat dhe Agroekologjinë në Europën Qendrore dhe Lindore](#)”, i zhvilluar në Bukuresht, Rumani, nga data 4 deri më 6 dhjetor 2024. Ky forum mbledhi së bashku përfaqësues të organizatave të prodhuesve të vegjël, politikëbërës, aktivistë dhe ekspertë nga i gjithë rajoni, për të adresuar tema të rëndësishme që ndikojnë në komunitetet rurale. Diskutimet përfshinë çështje si: të drejtat e fermerëve, e drejta për tokën, farat dhe biodiversitetin, si dhe Deklarata e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fermerëve dhe Punonjësve Ruralë (UNDROP), një kornizë e rëndësishme që thekson dinjitetin dhe mirëqenien e komuniteteve rurale. Gjithashtu, më 6 dhjetor, përfaqësueset morën pjesë në Konferencën Publike *Fermerët e vegjël advokojnë për Demokraci, të Drejta dhe Agroekologji*, ku u theksua rëndësia e demokracisë, mbrojtjes së të drejtave dhe praktikave agroekologjike për një të ardhme të qëndrueshme për komunitetet rurale.

Promovimi i librit “Bujqësia Biologjike” [Dhjetor 2024]

Më datë 23 dhjetor 2024, Koordinatorja Kombëtare e ANRD mori pjesë [në ceremoninë e promovimit të librit “Bujqësia Biologjike”](#) të autorit Prof. Enver Isufi, drejtues i organizatës anëtare të ANRD, Instituti i Bujqësisë Biologjike. Ky botim përfaqëson një kontribut të rëndësishëm në fushën e bujqësisë së qëndrueshme dhe ofron udhëzime praktike për fermerët, politikëbërësit dhe profesionistët mbi përballimin e sfidave globale si ndryshimet klimatike dhe humbja e biodiversitetit.

Ky aktivitet shënoi një moment të rëndësishëm për forcimin e bashkëpunimit midis ANRD, organizatave të saj anëtare dhe komunitetit akademik, si dhe për nxitjen e dialogut mbi politikat dhe praktikat që mbështesin zhvillimin e bujqësisë biologjike në Shqipëri.

PUBLIKIME 2024

Strategjia e Advokimit dhe Plan i Veprimit [mars 2024]

Aktivizmi rinor dhe advokacia nga poshtë-lart është thelbi i veprimtarisë së RYH. RYH mbështet të rinjtë në zonat rurale që të ushtrojnë zërin e tyre për të ndikuar politikëbërjen bujqësore dhe rurale, për t'i bërë këto procese të orientuara dhe të lidhura ngushtë me shqetësimet, interesat dhe prioritetet e të rinjve.

Për të patur një vizion të qartë të çështjeve kryesore në të cilat do të bazohet advokacia rinore, RYH ka përgatitur [Strategjinë e Advokimit dhe Planin e Veprimit](#). Anëtarët e Qendrës së Rinisë Rurale u përfshinë në procesin e identifikimit të sfidave dhe prioritetëve kryesore të të rinjve në zonat rurale, të cilat tashmë janë të konsoliduara në Strategjinë e Advokimit dhe Planin e Veprimit.

Konkluzione dhe rekomandime mbi Strategjinë Kombëtare e Zhvillimit të Agroturizmit në Shqipëri [mars 2024]

Në vijim të Takimit Konsultues mbi Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Agroturizmit në Shqipëri: Shanset për sukses, u hartuan një sërë [konkluzioneve dhe rekomandimesh](#) të cilat do të shërbejnë për përmirësimin e dokumentit strategjik.

Këto përpjekje përputhen me misionin e ANRD në promovimin e advokacisë nga poshtë-lart për politika rurale efektive, të hartuara dhe të zbatuara në bashkëpunim me komunitetet rurale dhe shënojnë një moment të

rëndësishëm në punën tonë të vazhdueshme për të unifikuar interesat dhe prioritetet e komuniteteve rurale, për t'i lidhur ato me qeverisjen dhe për të influencuar politika dhe veprime të institucioneve publike dhe të aktorëve të ndryshëm të interesit.

Deklarata e Parlamentit të Tretë Rural Shqiptar [maj 2024]

Në përpjekje për të avancuar demokracinë vendore, përfshirjen sociale dhe integrimin evropian, më 11–13 tetor Rrjeti Shqiptar për Zhvillim Rural (ANRD) në bashkëpunim me 34 organizata anëtare dhe Universitetin Bujqësor të Tiranës organizoi Parlamentin e Tretë Rural Shqiptar, duke mbledhur rreth 600 aktorë të ndryshëm të interesit. Edicioni i tretë u zhvillua me temën “*Jeta burore nga fshati*”, duke theksuar rolin thelbësor të zonave rurale në zhvillimin e vendit.

Rezultati kryesor i këtij takimi ishte [Deklarata e Parlamentit të Tretë Rural Shqiptar](#), dokument i cili sintetizoi diskutimet dhe rekomandimet e pjesëmarrësve. Dokumenti ofroi një bazë për dialog dhe bashkëpunim mes aktorëve të interesit, duke analizuar realitetin rural, identifikuar nevojat dhe problemet kryesore, reflektuar mbi vizionin dhe prioritetet, dhe duke përcaktuar veprimet kolektive për përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitetet rurale në të gjithë vendin.

Raporti vjetor i ANRD [qershor 2024]

[Raporti vjetor për vitin 2023](#) prezanton punën e ANRD, momentet kyçe të përpjekjeve, partneritetet dhe arritjet kryesore të vitit 2023. Raporti përbëhet nga dy pjesë: pjesa përshkruese e aktivitetit të ANRD dhe pasqyrat

financiare. Raporti u paraqit nga Koordinatorja Kombëtare në Bordin Ekzekutiv të ANRD dhe u miratua nga Asambleja e Përgjithshme më 14 qershor 2024.

Deklaratë mbi Sigurinë Ushqimore: Thirrje për reagim dhe integritet institucional [nëntor 2024] Shëndeti i konsumatorëve shqiptarë dhe evropian mbetet prioritarë dhe lidhet pashmangshmërisht me garantimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale që përmbushin standardet e cilësisë dhe sigurisë ushqimore. Rasti i mandarinave me prezencë të clorpirifosit, i bërë publik në media ka përforcuar nevojën për reagim të shpejtë dhe efektiv nga institucionet përgjegjëse. Përmes deklaratës [Mbi Sigurinë Ushqimore](#), ANRD dhe organizatat anëtare të veta kërkuar nga MBZHR, si dhe nga institucionet e tjera ligjzbatuese, një qasje transparente dhe të përgjegjshme për të adresuar situatën dhe për të forcuar besimin e publikut në sistemin e sigurisë ushqimore të vendit tonë.

Dokument i shkurtër politikash: Bujqësia 2025: Prioritet kombëtar në fjalë, por jo në vepra [nëntor 2024] Në nëntor të 2024, Ministria e Financave publikoi projekt buxhetin për vitin 2025, me një total prej 822.7 miliardë lekë. Sipas këtij buxheti, sektorët prioritarë janë Shëndetësia dhe Mbrojtja Sociale, Infrastruktura dhe Energjia, si dhe Arsimi dhe Sporti. Ndërkohë, MBZHR renditet e shtata për nga fondi i alokuar, me rreth 14.6 miliardë lekë. [Dokumenti i politikave: Bujqësia 2025: Prioritet kombëtar në fjalë](#), por jo në vepra ofron një analizë të fondeve të vëna në dispozicion për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural, si dhe situatës në të cilën gjendet ky sektor.

PARTNERITETE DHE RRJETËZIM 2024

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural është një organizatë e orientuar drejt krijimit të partneriteteve të reja dhe rrjetëzimit si një nga mënyrat kryesore për të shkëmbyer njohuri dhe praktika të mira dhe për të vazhduar misionin tonë të përbashkët në përmirësimin e mirëqenies së banorëve të komuniteteve rurale.

Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Universitetin Bujqësor të Tiranës

ANRD dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës firmosën në fillim të 2024 [Marrëveshjen e Mirëkuptimit për të forcuar dhe promovuar më tej bashkëpunimin e tyre dypalësh](#). Marrëveshja ka për qëllim bashkëpunimin e qëndrueshëm mes dy palëve në fusha me interes të përbashkët të tilla si: edukimi dhe trajnimi profesional, kërkimi shkencor, dialogu për politikat e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimi i qëndrueshëm bujqësor e rural.

Disa nga pikat e Marrëveshjes që u dakordësuan nga Rektori Sallaku dhe Znj. Azizaj përfshijnë promovimin e aktiviteteve lidhur me platformën e parlamentit rural shqiptar, asamblesë së të rinjve nga zonat rurale dhe nismat që mund të sjellin ndikim apo përmirësim të agjendës kombëtare bujqësore dhe rurale. Palët do të angazhohen edhe në organizimin e konferencave, seminareve apo aktiviteteve të tjera me tematika të ndryshme, nga ku UBT do të ofrojë asistencën profesionale për ANRD, RYH dhe organizatat anëtare të ANRD, bazuar në fushat kryesore të studimit dhe zhvillimet më të fundit të sektorit bujqësor jo vetëm në vend por edhe në nivelin ndërkombëtar.

PROMOVIMI I ÇMIMEVE NË ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM RURAL

Një nismë që i kushtohet nderimit të trashëgimisë së jashtëzakonshme të profesionistëve që kryesuan zhvillimin e qëndrueshëm rural në Shqipëri. ANRD synon të krijojë një trashëgimi që nxit zhvillimin dhe progresin e vazhdueshëm të komuniteteve rurale shqiptare, duke vlerësuar udhëheqësit dhe duke krijuar një rrjet të personave që sjellin ndryshimin dhe më tej përforcojnë përpjekjet e tyre në nivel kombëtar dhe lokal.

Çmimi “Liljana Isakaj” - Për Lidërsip në Fuqizimin e Grave të Zonave Rurale

Ky çmim është një nismë kushtuar nderimit të trashëgimisë së pasur të Liljana Isakajt, e cila ia kushtoi jetën zhvillimit rural dhe fuqizimit ekonomik të grave rurale. Si epitomë e grave rurale, Liljana hapi rrugën për progres, lidërsip dhe ndryshim pozitiv në komunitetet rurale. Ky çmim vlerëson individë që kanë kryer përpjekje të jashtëzakonshme për të përmirësuar jetën e grave rurale. Çmimi do të promovohet nga ANRD dhe ADAD malore çdo vit me rastin e organizimit të Pro-GraveRurale.

Edicioni i dytë i çmimit “[Liljana Isakaj](#)” - Për Lidërsip në Fuqizimin e Grave të Zonave Rurale ” vlerësoi me këtë çmim Marie Frrokun, e cila vjen nga Gjegjan i Pukës, ku ka dhënë kontributin e saj prej më shumë se 35 vitesh në zhvillimin social dhe ekonomik të zonës. Aktualisht, ajo punon si financiere në Bashkinë Fushë-Arrëz dhe drejton me përkushtim grupin e grave të Gjegjanit. Përzgjedhja e fitueses u bë nga një komitet vlerësues, përbërë nga përfaqësues të MBZHR, ANRD dhe Adad Malore. Çmimi u nda gjatë edicionit të gjashtë të eventit “Pro-Grave Rurale”, organizuar më 15 tetor 2024.

DALJE NË PUBLIK DHE KONTRIBUTE NË EVENTE TË RËNDËSISHME

Mbi buxhetin e alokuar për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural, Alert, Ora News

E ftuar në emisionin [Alert në Ora News](#), hulumtuesja e ANRD, Alba Tema diskutoi në lidhje me fondin e alokuar për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural në projekt buxhetin për vitin 2025. Ndër të tjera u diskutua pamjaftueshmëria e fondeve në një kohë kur sektori përballlet me sfida si rritja e çmimeve të inputeve dhe e kostos së fuqisë punëtore, nevoja për mjete paketuese dhe ruajtëse, si dhe kapacitete magazinuese, mungesa e kontratave dhe marrja e çmimeve jo të drejta për fermerët. Prioritete kryesore mbeten rritja e mbështetjes buxhetore, përfshirja e fermerëve në hartimin e skemave të mbështetjes dhe hartimi i skemave në bazë jo konkurruese.

Eventi lançues i programit “Bujqësia Dixhitale dhe Transformimi Rural në Shqipëri (DART)”

Koordinatorja Kombëtare e ANRD, ishte e ftuar në eventin lançues të programit “[Bujqësia Dixhitale dhe Transformimi Rural në Shqipëri \(DART\)](#)” organizuar nga FAO, i cili synon të promovojë përdorimin e mjeteve digjitale si katalizatorë për rritjen e transparencës, përmirësimin e efikasitetit të prodhimit dhe uljen e kostove në sektorin e bujqësisë. Në fjalën e saj, ajo theksoi rëndësinë e këtij programi duke u shprehur se ky hap është i domosdoshëm për të garantuar që komunitetet rurale të Shqipërisë të mos mbeten pas në epokën digjitale.

Gjatë eventit, u prezantuan edhe platformat që ANRD ka krijuar me qëllim që të sjellë më pranë zërin e komuniteteve rurale me institucionet e qeverisjes vendore dhe qendrore. Këto iniciativa përfshijnë Parlamentin

Kombëtar Rural, Qendrën e Rinisë Rurale dhe Pro Grave Rurale, të cilat përbëjnë mekanizma të rëndësishëm për fuqizimin e aktorëve lokalë dhe për rritjen e pjesëmarrjes së tyre në proceset vendimmarrëse.

Mbi deklaratën e grave dhe vajzave nga komunitetet rurale, A2 CNN

Hulumtuesja e ANRD, Alba Tema, ishte e ftuar në intervistë në televizionin A2 CNN, ku ndau me mediat prioritetet e [Deklaratës së Grave dhe Vajzave nga Komunitetet Rurale](#).

Gjatë diskutimit ajo theksoi se pavarësisht kontributit të rëndësishëm që gratë dhe vajzat japin në zhvillimin e komuniteteve rurale, ato vijojnë të përballen me qasje të pabarabartë në të drejtat e pronësisë mbi tokën, me peshën e punës së papaguar dhe punës informale, si edhe me kufizime të lidhura me stereotipe gjinore të rrënjosura.

ANRD riafirmon angazhimin e saj për përmirësimin e mirëqenies së grave dhe vajzave në zonat rurale. Në këtë kuadër, rrjeti ka punuar me dy grupe grash në Leskovik dhe në Shirgjan, duke synuar fuqizimin e tyre ekonomik dhe social përmes rritjes së kapaciteteve, nxitjes së vetëpunësimit dhe pjesëmarrjes aktive në jetën komunitare.

PROJEKTET 2024

Akademia nga Ferma në Tryezë për Ballkanin Perëndimor të Gjellbër – E ardhmja jonë e përbashkët evropiane [janar 2023 – janar 2027]

Projekti rajonal “[Akademia nga Ferma në Tryezë për Ballkanin Perëndimor të Gjellbër – E ardhmja jonë e përbashkët evropiane](#)” zbatohet nga konsorciumi i Rrjeteve Kombëtare të Zhvillimit Rural në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Kroaci si dhe nga platforma e tyre rajonale e bashkëpunimit, Rrjeti Ballkanik për Zhvillim Rural. Ky projekt synon të forcojë kapacitetet e sektorit civil të angazhuar në zhvillimin rural dhe bujqësor në rajon për të qenë aktorë kyç në adresimin e sfidave të shoqërisë, në lidhje me ndryshimet klimatike dhe humbjet e biodiversitetit, veçanërisht në zbatimin e kuadrit strategjik evropian në nivel kombëtar dhe vendor, të Marrëveshjes së Gjellbër dhe Strategjisë ‘Nga Ferma në Tryezë’, si dhe mbështetjes së nismave të gjellbra dhe novatore për sisteme të qëndrueshme ushqimore. Për shumë më shumë informacion [Fact Sheet_Farm to Fork Academy for Green Western Balkans – Shqip \(002\)](#).

CultiVETing: Cultivating Entrepreneurship in the Agrifood Sector through VET” [janar 2024-janar 2027]

“[CultiVETing](#) synon të mbulojë hendekun midis sektorit Arsimit dhe Formimit Profesional dhe nevojave të tregut të punës në sektorin agroushqimor në Ballkanin Perëndimor.

Ndërhyrja fokusohet në ngushtimin e hendekut midis Arsimit dhe Formimit Profesional dhe biznesit në sektorin agro-ushqimor dhe konsumit të qëndrueshëm është strategjik. Kjo përputhet me politikat kombëtare të Shqipërisë dhe Kosovës, si dhe prioritetet rajonale të Ballkanit Perëndimor, si Strategjia e Re e Rritjes për Ballkanin Perëndimor, që synon të kalojë nga një model ekonomik tradicional në një ekonomi të qëndrueshme, në përputhje me Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane.

Fuqizimi dhe promovimi i trashëgimisë kulturore në Krujë [maj 2024- korrik 2024]

Projekti “[Fuqizimi dhe promovimi i trashëgimisë kulturore në Krujë](#)” u mbështet nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe u fokusua në promovimin e artizanatit tradicional krutan dhe praktikimin e mjeshtërive kryesore nga fëmijët e qytetit të Krujës. Qëllimi i kësaj nisme është të krijojë një mjedis nxitës për artizanatin tradicional të qytetit të Krujës, duke ofruar një platformë të përshtatshme për të rinjtë për të njohur, praktikuar dhe zhvilluar mjeshtëritë e artizanatit tradicional. Specifikisht, kjo nismë ofroi një kamp veror për fëmijët e qytetit të Krujës për të promovuar artizanatin tradicional dhe mësuar praktikimin e mjeshtërive kryesore. Në të ardhmen ata do të jenë qytetarë të përgjegjshëm për trashëgiminë e tyre kulturore.

RURALBANIA: Nisma për mbështetjen dhe promovimin e produkteve bujqësore tradicionale për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale shqiptare" [shtator 2022 – gusht 2025]

[RURALBANIA](#) është një nismë që ka si synim mbështetjen dhe promovimin e produkteve bujqësore tradicionale për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale. Ndërhyrja mbështet autoritetet shqiptare dhe shoqërinë civile

në zbatimin e Agjendës 2030, duke iu referuar Qëllimit Strategjik të Qëndrueshëm 2 dhe promovimit të bujqësisë së qëndrueshme . Projekti gjithashtu mbështet rrugën e anëtarësimit të Shqipërisë në BE, në kuadër të së cilës përshtatja me Politikën e Përbashkët Bujqësore përfaqëson një element themelor. Ndërhyrja synon të rrisë produktivitetin dhe vlerën e shtuar të arritur nga fermat familjare që operojnë në zinxhirë furnizimi me potencial të lartë në zonat malore të pafavorizuara të Shqipërisë së Veriut.

Kjo ndërhyrje tre-vjeçare fokusohet në zonat malore të Shqipërisë verilindore dhe në zinxhirë të kufizuar prodhimi, për të maksimizuar ndikimin socio-ekonomik në komunitetet si më poshtë: - Rajoni Lindor i Shkodrës: bletari, fruta pylli 5 - Qarku i Kukësit: mbarështimi i deleve dhe dhive - Rajoni i Dibrës: pemë frutore. Ruralbania financohet nga Agjencia Italiane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatohet nga Volontari nel Mondo RTM, në partneritet me CIA – Agricoltori Italiani, Rajoni Emilia Romagna, ADAD Malore, AgroPuka, Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor dhe Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural.

“Fuqizimi i grave në zonat rurale dhe turizmi” [shtator 2022- dhjetor 2024]

Projekti “[Fuqizimi i grave ne zonat rurale dhe turizmi](#)” financohet nga Qeveria Italiane dhe zbatohet nga UN Women Albania and FAO, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Projekti zbatohet nga Rrjeti Shqiptar për Zhvillim Rural në rolin e palës përgjegjëse për UN Women Albania. Projekti synon të kontribuojë në përmirësimin e situatës ekonomike të vajzave dhe grave në zonat rurale në bashkitë Elbasan dhe Kolonjë. Qasja që do të ndiqet në mbështetje të fuqizimit ekonomik dhe social të grave rurale do të jetë në

përputhje me kuadrin ligjor në fuqi duke mundësuar formalizimin e Grupeve Lokale të Veprimit bazuar në praktikat më të mira evropiane në zbatimin e qasjes Leader. Zbatimi i suksesshëm i LEADER, zhvillimi lokal i udhëhequr nga komuniteti dhe zhvillimi rural varet nga krijimi i një kuptimi të përbashkët mes aktorëve të interesit mbi zhvillimin e qëndrueshëm rural dhe të parimeve që qëndrojnë në themel të qasjes LEADER.

TOKA JONË - Ripërdorimi i tokave të konfiskuara për të promovuar bujqësinë sociale [janar 2022-gusht 2025]

Projekti ‘[TOKA JONË- Ripërdorimi i tokave të konfiskuara për të promovuar bujqësinë sociale](#)’ financohet nga Bashkimi Evropian dhe synon të forcojë sipërmarrjen sociale në menaxhimin e aseteve të konfiskuaranga organizatat kriminale bazuar në modelet e bujqësisë sociale. Qëllimi kryesor i ‘TOKA JONË’ është që të përcaktojë një model të bujqësisë sociale të qëndrueshme nëpërmjet trajnimit dhe punësimit të grupeve vulnerabël dhe të marginalizuara si dhe përfshirjes së komunitetit lokal në njësrë fushatash ndërgjegjëse. Për këtë qëllim, ‘TOKA JONË’ do të ofrojë mbështetje për iniciativa novatore të bujqësisë sociale përmes ripërdorimit të tokave të konfiskuara si një mjet për të promovuar zhvillimin socio-ekonomik, mundësitë e punësimit të grupeve vulnerabël, ndjenjën e ligjshmërisë dhe sundimit të ligjit.

LIQENET E SHQIPËRISË – Promovimi i modeleve të turizmit të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm për zhvillimin gjithëpërfshirës të komuniteteve” [1 gusht 2022 – 31 korrik 2025]

Projekti synon të promovojë modele novatore të turizmit të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm në zonat që

lidhen me dy liqenet kryesore të Shqipërisë - Liqenin e Shkodrës dhe Liqenin e Pogradecit/Ohrit - në krahasim me modelet e turizmit invaziv dhe zhvillimit në zgjerim të fortë në të gjithë territorin shqiptar, me qëllimin për të kontribuar në një rritje ekonomike gjithëpërfshirëse të Shqipërisë. Projekti “LAGHI D'ALBANIA” financohet nga Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim (AICS) dhe po zbatohet nga COSV dhe VIS në partneritet me Rrjetin Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD), Universitetin Bujqësor të Tiranës (UBT), Shoqatën Italiane për Turizmin e Përgjegjshëm (AITR), Diesis Network, Kallipolis, Studio Azue, në bashkëpunim me Fondacionin ABC dhe Fondacionin Partneritet për Zhvillim (PfD).

“Forcimi i partneriteteve për zhvillimin vendor përmes fuqizimit të rrjeteve kombëtare dhe rajonale të zhvillimit rural në Ballkanin Perëndimor” [nëntor 2022-qershor 2024]

“Forcimi i partneriteteve për zhvillimin vendor përmes fuqizimit të rrjeteve kombëtare dhe rajonale të zhvillimit rural në Ballkanin Perëndimor” është projekt që po mbështetet financiarisht nga projekti rajonal i GIZ “Mbështetje për diversifikimin ekonomik të zonave rurale në Evropën Juglindore (SEDRA)”. Qëllimi kryesor i këtij projekti është rritja e potencialeve të punësimit dhe të ardhurave në zonat rurale në vendet e Evropës Juglindore. Mbështetja ka në fokus rritjen e njohurive dhe shkëmbimin e eksperiencës, forcimin e kapaciteteve të aktorëve kryesorë për të ndërtuar një model funksional nga poshtë- lart për zhvillimin rural me pjesëmarrje dhe zbatimin e zhvillimit vendor të udhëhequr nga komuniteti dhe qasjen LEADER.

ANËTARËT E RINJ 2024

ANRD mbetet e hapur ndaj zgjerimit të anëtarësisë dhe përfaqësimit të komuniteteve rurale në të gjithë vendin, deri në zonat më të thella malore. Gjatë vitit 2024, ANRD-së iu bashkuan tre organizata të reja anëtare:

Shoqata Diakonia Agapes

Diakonia Agapes është një organizatë e themeluar në vitin 1992 dhe që prej vitit 2000 është pjesë e Fondacionit “Fryma e Dashurisë”. Ajo punon me komunitete të ndryshme në Shqipëri dhe në rajon, me fokus të veçantë tek grupet në nevojë, duke ofruar mbështetje teknike, ndërgjegjësim dhe lehtësim të situatave emergjente.

Misioni i saj është të nxisë shpresën, besimin dhe përgjegjshmërinë shoqërore, si dhe të forcojë vetë-iniciativën e individëve dhe komuniteteve. Qëllimi kryesor i Diakonia Agapes është zhvillimi i burimeve njerëzore dhe materiale në Shqipëri, duke mobilizuar dhe organizuar mbështetje financiare, materiale dhe njerëzore si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij.

Një nga fushat kryesore të punës së saj është zhvillimi i integruar rural, me synimin për të përdorur në mënyrë sa më efikase burimet natyrore, njerëzore dhe financiare lokale. Në këtë kuadër, organizata kontribuon në përmirësimin e kushteve të jetesës në zonat rurale përmes trajnimeve në marketing dhe prodhim bujqësor për fermerët, ofrimit të asistencës teknike, shërbimeve të ekstensionit dhe organizimit të fushatave ndërgjegjëse.

Grupi Vendor i Veprimit “Kolonja e Gjelbër”

GVV “Kolonja e Gjelbër” u krijua fillimisht në vitet 2017-2018 në kuadër të projektit të shërbimeve mjedisore, me mbështetjen financiare të Bankës Botërore dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Falë mbështetjes së projektit “Fuqizimi i Grave në zonat Rurale dhe Turizmi”, GVV filloi një proces intensiv të gjallërimit të territorit dhe mobilizimit të komunitetit për rishikimin e partneritetit vendor dhe për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit Vendor të zonës me pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirëse.

Në vitin 2024, GVV Kolonja e Gjelbër është e autorizuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për të funksionuar si Grup Vendor Veprimi -një strukturë partneriteti e lejueshme për mbështetje financiare nga masa Leader e programit IPARD III. Vizioni i GVV “Kolonja e Gjelbër” është rikthimi i dëshirës së komunitetit për të punuar dhe investuar në zonën e tyre, falë zhvillimit të integruar vendor përmes përdorimit të burimet natyrore në mënyrë të qëndrueshme, shfrytëzimit të infrastrukturës rurale të përmirësuar dhe promovimit dhe ruajtjes së biodiversitetit të pasur dhe trashëgimisë kulturore historike të pashembullt në pasurinë e vet.

Qendra Konsumatori Shqiptar

Qendra Konsumatori Shqiptar është një organizatë jofitimprurëse që vepron në fushën e mbrojtjes së të drejtave të konsumatorit në Shqipëri.

Misioni i Qendrës së Konsumatorit Shqiptar është të mbrojë të drejtat dhe interesat e konsumatorëve në Shqipëri, duke siguruar informacion të qartë, këshilla të besueshme dhe mbështetje në rastet e konflikteve me



bizneset. Qendra synon të rrisë ndërgjegjësimin për të drejtat e konsumatorëve, të promovojë praktika të ndershme tregtare dhe të kontribuojë në krijimin e një mjedisi ekonomik të drejtë dhe transparent për të gjithë. Në thelb, ajo është zëri i konsumatorit për mbrojtje, edukim dhe përmirësim të shërbimeve dhe produkteve në treg.

Qendra synon të sigurojë akses të qytetarëve në informacion të besueshëm dhe të kuptueshëm mbi të drejtat e konsumatorit, forcojë mekanizmat e mbrojtjes së konsumatorit në nivel ligjor dhe institucional, si dhe të nxisë përmirësimin e praktikave tregtare dhe rritjen e transparencës në treg.

MEDIAT SOCIALE

Karakteristikat demografike të ndjekësve së faqes Facebook

Figura 1. Ndjekësit e faqes sipas gjinisë në vitin 2024





Figura 2. Ndjekësit e faqes sipas moshës në vitin 2024



Gjatë vitit të kaluar 52% e ndjekësve të ANRD ishin femra dhe 48% e tyre meshkuj. Përsa i përket moshës pjesa më e madhe e tyre i përket grupmoshës 25-34 vjeç (35%), ndërsa grupmosha që zë përqindjen më të ulët është mbi 65 vjeç me rreth 3%.

Mediat Sociale

Karakteristikat demografike të ndjekësve

Figura 3. Ndjekësit e faqes së ANRD sipas qyteteve në vitin 2024






Figura 4. Ndjekësit e faqes së ANRD sipas vendeve në 2024



Pjesa më e madhe e ndjekësve të faqes së facebook të ANRD janë nga Tirana (36%), Shkodra (5%) dhe Përmeti (3%). Pas ndjekësve nga Shqipëria (77%), ndjekësit nga Italia zënë pjesën më të madhe me 6%, ndjekur nga Kosova me 4%.



Figura 5. Statistika mbi postimet e ANRD në vitin 2024



Në vitin 2024, ANRD ndiqej nga 3,843 ndjekës, prej të cilëve 280 janë ndjekës të rinj.

Postimet kanë patur një shikueshmëri prej mbi 53 mijë personash dhe rreth 5 mijë pëlqime.



POSTIMET MË POPULLORE TË 2024:

1- Ndarja e Deklaratës së Grave dhe Vajzave nga komunitetet rurale

☞ Forca dhe rezilienca e komuniteteve tona rurale rrënjëzohen në kontributet e jashtëzakonshme të grave dhe vajzave. Në Shqipëri, rreth 40% e grave angazhohen aktivisht në sektorin bujqësor dhe luajnë një rol të rëndësishëm në të gjithë zinxhirin e vlerës. Megjithatë, edhe pse ky kontribut është kyç, ndarjet vazhdojnë për shkak të qasjes së pabarabartë në të drejtat e pronësisë së tokës...

19,455 shikime, 83 reagime, 3 koment, 3 ndarje

2- Konkluzione dhe rekomandime mbi strategjinë kombëtare të agroturizmit

📖 Të dashur miq të faqes sonë, po ndajmë me ju përmbledhjen e konkluzioneve dhe rekomandimeve që ANRD përgatiti dhe ndau me #Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në kuadër të konsultimit publik të Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Agroturizmit.

10,548 shikime, 89 reagime, 4 koment, 2 ndarje

3. Workshopit i Programit të Bursave për fermerët e rinj-Ruralbania

Dita e parë e Workshopit të Programit të Bursave për projektin Ruralbania filloi sot në Peshkopi, pranë Nëna Dashuri Agroturizëm, ku pjesëmarrësit u njohën me aktivitetet e ndryshme që mund të ndërmerren për diversifikimin e aktiviteteve në fermë dhe mundësitë e reja të trajnimeve. Gjithashtu ata u njohën me Qendrën e Rinisë Rurale dhe mundësitë që pjesëmarrja aktive në këtë rrjet të rinjsh nga e gjithë Shqipëria, mund t'u japë.”.

2057 shikime, 57 reagime, 3 komente, 4 ndarje



RRJETI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN RURAL

Rr Qemal Stafa, Pazari i ri, pallati n74, kati 2. Tiranë

www.anrd.al | info@anrd.al